Shkurt 2024 | Nr. 35

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al

YouTube Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania

## TAKIMI I SEKRETARIT AMERIKAN TË SHTETIT ME DREJTUES TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" | Sheshi "Nënë Tereza" | Godina nr. 13 | Tiranë, Shqipëri



# TAKIMI I SEKRETARIT AMERIKAN TË SHTETIT ME DREJTUES TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe drejtues të institucioneve të drejtësisë, në vend, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese znj. Holta Zaçaj, kryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi dhe drejtuesi i SPAK z. Altin Dumani zhvilluan një takim me Sekretarin amerikan të Shtetit z. Antony Blinken, gjatë vizitës së tij në Tiranë, më 16 Shkurt 2024.

Lidhur me takimin, Sekretari Blinken u shpreh në Twitter se: "Reforma në drejtësi është thelbësore për Shqipërinë dhe përpjekjet e saj për integrim në BE. U takova me drejtuesit e reformës në drejtësi në Tiranë për të përgëzuar progresin e tyre në avancimin e shtetit të së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit."

**Sekretari Blinken u shpreh në Twitter se: "Reforma në drejtësi është thelbësore për Shqipërinë dhe përpjekjet e saj për integrim në BE. U takova me drejtuesit e reformës në drejtësi në Tiranë për të përgëzuar progresin e tyre në avancimin e shtetit të së drejtës dhe luftën kundër korrupsionit."**



Ambasada e SHBA në Shqipëri përcolli përmes një postimi në Twitter mesazhet e takimit: “Sekretari i Shtetit Antony Blinken përsëriti angazhimin e qëndrueshëm të Shteteve të Bashkuara për reformën në drejtësi në Shqipëri gjatë një takimi me krerët e drejtësisë dje. Megjithëse reforma nuk është e shpejtë, e përsosur, apo e lehtë, ky është momenti që institucionet e reja të drejtësisë të veprojnë me guxim ndaj pandëshkueshmërisë dhe të nxisin besimin e publikut në sundimin e ligjit. Këto sfida janë të mëdha, por Shtetet e Bashkuara qëndrojnë fort pas këtyre institucioneve dhe do të mbetemi të palëkundura në mbështetjen tonë.”






# EKIPI I ILD-SË TRAJNOHET MBI ÇËSHTJE TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Njësia e Inspektorëve dhe ajo e ndihmës Inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë në trajnimin e targetuar mbi identifikimin dhe adresimin e çështjeve të konfliktit të interesit në kuadrin e hetimit disiplinor, organizuar nga misioni i ekspertëve të Projektit EU4Justice, që asiston ILD-në.








Në fjalën përshëndetëse në nisje të trajnimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani shprehu vlerësimin për Projektin EU4Justice, një nga partnerët e rëndësishëm ndërkombëtarë, që mbështet ambiciet e ILD-së për trajnimin e vazhdueshëm dhe profesional të ekipit të Inspektorëve e ndihmës Inspektorëve me praktikat më të mira të hetimit disiplinor, në rastin konkret të GJEDNJ-së, mbi çështje të konfliktit të interesit të magjistratëve.

“Identifikimi, adresimi dhe trajtimi i çështjeve të konfliktit të interesit, në kuad-






rin e hetimit disiplinor mbetet i rëndësishëm për vetë rolin që ka ky proces, që është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet hetimit të shkeljeve disiplinore të magjistratëve, tha z. Metani.

Funksioni duhet të ushtrohet në mënyrë të ndërgjegjshme, që nënkupton vetëdijen e magjistratit për rëndësinë e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive që i janë ngarkuar me ligj, si dhe për pasojat që çdo sjellje e magjistratit ka tek sistemi gjyqësor apo i prokurorisë, por edhe tek zhvillimi i shoqërisë në tërësi.





**“Funksioni duhet të ushtrohet në mënyrë të ndërgjegjshme, që nënkupton vetëdijen e magjistratit për rëndësinë e të gjitha detyrave dhe përgjegjësive që i janë ngarkuar me ligj, si dhe për pasojat që çdo sjellje e magjistratit ka tek sistemi gjyqësor apo i prokurorisë, por edhe tek zhvillimi i shoqërisë në tërësi. Përmbushja e funksionit me vetëpërmbajtje dhe maturi nënkupton shmangien e çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me ligjin apo me vetë etikën, pasi pjesë e detyrës është edhe mbrojtja dhe forcimi i reputacionit të organeve të drejtësisë dhe besimit të publikut në sistemin gjyqësor.” tha z. Metani**

Përmbushja e funksionit me vetëpërmbajtje dhe maturi nënkupton shmangien e çdo sjellje të papërshtatshme, që bie në kundërshtim me ligjin apo me vetë etikën, pasi pjesë e detyrës është edhe mbrojtja dhe forcimi i reputacionit të organeve të drejtësisë dhe besimit të publikut në sistemin gjyqësor.”

Eksperti kryesor i Projektit Z. Álvaro García Pérez-Iraola falenderoi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për bashkëpunimin e frytshëm, angazhimin e stafit në aktivitetet e ofruara nga Projekti, te cilat kanë për qëllim të rrisin kapacitetet e institucionit, duke ndarë eksperiencat më të mira europiane.

Z. Pérez-Iraola solli në vëmendje konceptimin e këtij trajnimi në fushën e trajtimit të konfliktit të interesit në kuadër të hetimit disiplinor, përmes ndërthurjes së aspektit teorik me trajtimin e kazuseve praktike.






Trajnimi dy ditori i zhvilluar nga ish inspektori francez i drejtësisë, magjistrati Vincent Delbos, ndërthuri teorinë me zhvillimin e aftësive praktike, duke nxitur punën në grupe për krijimin e strategjive për menaxhimin efektiv të konfliktit të interesit, nëpërmjet katër rasteve studimore të marra nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe përvoja të tjera ndërkombëtare, lidhur me çështjet e identifikuara të konfliktit të interesit.

Pjesë e sesioneve të trajnimit ishin edhe diskutimi dhe krahasimi i përvojës shqiptare dhe ndërkombëtare mbi rëndësinë dhe pasojat e mosrespektimit të parimeve dhe standardeve të konfliktit të interesit.



# SHKURTI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Shkurt** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **89 ankesa,** të cilat 88 janë paraqitur nga qytetarë dhe 1 ankesë nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Shkurt 2024**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

| ARKIVIME | VERIFIKIME | PROCESI DISIPLINOR |
|---|---|---|
| **46 vendime nga 70 ankesa të shqyrtuara,** konkretisht:<br><br>- 41 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar<br><br>- 5 vendime arkivimi pas verifikimit | **13 vendime verifikimi,** nga praktikat e ILD-së. | -**1 vendim për përfundim hetimi disiplinor** për 1 prokuror.<br><br>**-3 kërkesa për procedim disiplinor** për 2 gjyqtarë, 1 prokuror. |

# ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.
* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD **www.ild.al**, në seksionin "**Si pranohen ankesat**".

# SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Shkurt 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **3 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuara prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.











## Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.





***Gjatë muajit* Shkurt 2024,**
**Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun**
***ka pritur* 25 ankues,**
***të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë***
***dhe* 33 telefonata *me qytetarë,***
***të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre***
***ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.***



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Shkurt 2024,** pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **13 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

# ILD NË TWITTER

**Inspektori i Larte i Drejtesise A** Follow ···
@ILD_Albania

Sot #ILD🇦🇱 mbush 4 vjet nga nisja e funksionimit!🎉 Motivimi është edhe më i lartë për të kontribuar për një sistem drejtësie me standarde dhe që përmbush pritshmëritë e qytetarëve.

Translate post




From ild.al

Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani reposted

**Secretary Antony Blinken** Follow ···
@SecBlinken

Justice reform is crucial for Albania and its EU integration efforts. I met with justice reform leaders in Tirana to commend their progress in advancing the rule of law and combating corruption.



10:54 PM · Feb 15, 2024 · **87.8K** Views

← **Post**

**Inspektori i Larte i Drejtesise A** Follow ···
@ILD_Albania

📍 Po ndodh: Ekipi i Inspektorëve dhe ndihmës Inspektorëve të ILD-së, trajnim mbi identifikimin dhe adresimin e çështjeve të konfliktit të interesit në kuadër të hetimit disiplinor. #ILD⚖️🇦🇱 #EU4Justice🇪🇺

Translate post



← **Post**

Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani reposted

**USEmbassyTirana** Follow ···
@USEmbassyTirana

.@SecBlinken reiterated the United States' enduring commitment to Albania's justice reform during a meeting with justice leaders today. Though reform is neither quick, perfect, or easy, this is the moment for new justice institutions to courageously take on impunity and foster public trust in the rule of law. These challenges are great, but the United States stands firmly behind these institutions and will remain steadfast in our support.



**Inspektori i Larte i Drejtesise A** Follow ···
@ILD_Albania

👉Ekipi ynë i Zyrës së Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun pret dhe asiston qytetarët që i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë fizikisht për ankesë ndaj magjistratëve ose informacion, cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00. #ILD⚖️

Translate post



12:30 PM · Feb 23, 2024 · **99** Views

← **Post**

**Inspektori i Larte i Drejtesise A** Follow ···
@ILD_Albania

Metani: Trajnimi i vazhdueshëm i ekipit të ILD-së me praktikat më të mira ndërkombëtare mbi hetimin disiplinor, pjesë e ambicjes për të patur nivelin më të lartë profesional në punën tonë. #trajnim #konfliktiiinteresit #magjistratët #ILD⚖️🇦🇱#EU4Justice🇪🇺

Translate post



**SHKURT 2024**

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

# KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri







*Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD*